



www.d4d-ks.org
Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

“hd



MONITORIMI I DEKLARATËS SË MIRËSJELLJES NË MEDIA SOCIALE GJATË ZGJEDHJEVE LOKALE 2021

MONITORIMI I DEKLARATËS SË MIRËSJELLJES NË MEDIA SOCIALE GJATË ZGJEDHJEVE LOKALE 2021

Prishtinë, dhjetor 2021

Përgatitur nga: Demokraci për Zhvillim (D4D)

Të drejtat e autorit ©2021. Demokraci për Zhvillim (D4D).








Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimeve të pjesëve të shkurtra me qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit të të dhënave, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të D4D.

Ky raport monitorimi është realizuar në kuadër të projektit "Kodi i mirësjelljes në rrjete sociale" implementuar nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D), dhe mbështetur nga Qendra për Dialog Humanitar ('HD).

Deklarata e nënshkruar nga

- 6** Partitë politike
- 4** Mediat
- 7** OShC-të

Rrjetet sociale të monitoruara

-  Facebook
-  Instagram
-  Twitter
-  TikTok
-  Youtube
-  Uebfaqe/Blogje
-  Viber/WhatsApp

Ekipi i monitorimit

10 gazetarë të rinj janë angazhuar në monitorimin e përmbajtjeve në rrjetet sociale gjatë fushatës zgjedhore

Të gjeturat kryesore


27 komuna

197 shkelje

- Facebook **76 %**
- Youtube **18 %**
- Uebfaqe **4 %**
- Të tjera **4 %**

- 62 %** Gjuhë e urrejtjes
- 4 %** Dezinformata
- 4 %** Meme
- 3 %** Lajme të rreme
- 2 %** Informata jashtë kontekstit
- 2 %** Ngacmime personale
- 5 %** Të tjera

- Vetevendosje! **67 %**
- AAK **14 %**
- LDK **11 %**
- PDK **6 %**



- 34 %** Mediat
- 27 %** Partitë Politike
- 25 %** Kandidatët
- 8 %** Mbështetësit e partive
- 6 %** Të tjerë

- 32 %** Vetevendosje!
- 27 %** AAK
- 17 %** LDK
- 16 %** PDK

Përmbajtja

Hyrje	6
Metodologjia	8
<i>Fushëveprimi i monitorimit</i>	8
<i>Njësia e monitorimit</i>	9
<i>Sigurimi i cilësisë</i>	9
<i>Angazhimi i palëve të interesuara</i>	10
Gjetjet kryesore	11
<i>Të përgjithshme</i>	11
<i>Partitë politike dhe kandidatët</i>	15
<i>Mediat</i>	19
<i>Shkeljet e raportuara me bazë gjinore</i>	21
<i>Shkeljet e raportuara me bazë etnike</i>	22
Përfundime	24
Rekomandime	26
Shtojcat	27
<i>Shtojca 1: Lista e palëve nënshkruese të deklaratës</i>	27
<i>Shtojca 2: Deklaratë për partitë politike dhe kandidatët</i>	28
<i>Shtojca 3: Deklaratë për organizatat joqeveritare</i>	29
<i>Shtojca 4: Deklaratë për mediat</i>	30
<i>Shtojca 5: Fjalorth i shprehjeve kryesore</i>	31
<i>Shtojca 6: Skema e monitorimit</i>	32

Deklarata e nënshkruar nga

- 6** Partitë politike
- 4** Mediat
- 7** OShC-të

Rrjetet sociale të monitoruara

- Facebook
- Instagram
- Twitter
- TikTok
- Youtube
- Uebfaqe/Blogje
- Viber/WhatsApp

Ekipi i monitorimit

- 10** gazetarë të rinj janë angazhuar në monitorimin e përmbajtjeve në rrjetet sociale gjatë fushatës zgjedhore

Të gjeturat kryesore


27 komuna

197 shkelje

- Facebook **76 %**
- Youtube **18 %**
- Uebfaqe **4 %**
- Të tjera **4 %**

- 62 %** Gjuhë e urrejtjes
- 4 %** Dezinformata
- 4 %** Meme
- 3 %** Lajme të rreme
- 2 %** Informata jashtë kontekstit
- 2 %** Ngacmime personale
- 5 %** Të tjera

- Vetevendosje! **67 %**
- AAK **14 %**
- LDK **11 %**
- PDK **6 %**



- 34 %** Mediat
- 27 %** Partitë Politike
- 25 %** Kandidatët
- 8 %** Mbështetësit e partive
- 6 %** Të tjerë

- 32 %** Vetevendosje!
- 27 %** AAK
- 17 %** LDK
- 16 %** PDK

Hyrje

Më 17 tetor 2021 në Kosovë u mbajtën zgjedhjet lokale për zgjedhjen kryetarëve të komunave dhe përfaqësuesve të kuvendeve komunale në 38 komuna të Kosovës. Në 21 komuna në të cilat kandidatët për kryetar komune nuk fituan shumicën në raundin e parë (50% +1), më 14 nëntor 2021 u mbajtën zgjedhjet e raundit të dytë. Përkundër mangësive të kuadrit ligjor dhe sfidave të përsëritura në lidhje me administrimin e votimit jashtë vendit dhe mungesën e pluralizmit në komunat me shumicë serbe, zgjedhjet u konsideruan përgjithësisht si të lira dhe të ndershme dhe përfaqësuese të vullnetit të popullit.

Gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2021, Demokraci për Zhvillim realizoi një pilot-projekt të mbështetur nga Qendra për Dialog Humanitar (Qendra HD), që kishte për qëllim t'i angazhonte partitë politike, kandidatët, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile që të nënshkruajnë një Deklaratë të Mirësjelljes në Mediat Sociale. Me nënshkrimin e këtyre deklaratave, palët u zotuan që të luftojnë kundër gjuhës së urrejtjes, lajmeve të rreme, dezinformimit, gjuhës shpifëse dhe përmbajtjeve të tjera që mund të kenë ndikim negativ në mjedisin zgjedhor. Këto deklaratë u përgatitën në bashkëpunim me akterët zgjedhorë në seminarin e mbajtur në gusht të vitit 2021 dhe janë përshtatur enkas për akterët specifikë dhe rolet e tyre. Deklaratat u nënshkruan nga 6 parti politike, katër media (përfshirë Këshillin për Mediat e Shkruara të Kosovës) dhe 7 organizata të shoqërisë civile. Lista e subjekteve që kanë nënshkruar Kodin e Mirësjelljes është paraqitur në Shtojcën 1.

Në kuadër të Projektit u themelua një njësi monitorimi, e përbërë nga 10 persona me përvojë edukative në gazetari, të cilët ishin të përfshirë në monitorimin e përmbajtjes në media sociale gjatë fushatës zgjedhore. Monitorimi u zhvillua gjatë periudhës së fushatës dhe vetëm për përmbajtjen në mediat sociale. Për më shumë informata lidhur me monitorimin, ju lutemi rishikoni pjesën e metodologjisë më poshtë në Shtojcën 6.

Ky ishte pilot-projekt dhe ndër të parët e këtij lloji të realizuar në Kosovë. Projekti u mirëprit nga partitë politike, shoqëria civile, mediat dhe palët e tjera të interesit në zgjedhje, të cilët i shohin lajmet e rreme, gjuhën e urrejtjes dhe përmbajtjet e tjera shpifëse si sfida e re dhe në rritje në zgjedhjet në Kosovë. Projekti përfitoi nga mësimet e nxjerra dhe përvojat në realizimin e projekteve të ngjashme në vendet e tjera nga Qendra HD.¹

Ky projekt ishte pilot për të eksploruar vlefshmërinë dhe mundësitë e monitorimit. Gjetjet e këtij raporti paraqesin një përmbledhje të përgjithshme të përmbajtjes së mbuluar nga njësia e monitorimit (197 shkelje të raportuara), por mund të mos përfshijë tërë

¹ Për më shumë informata lidhur me Qendrën HD dhe projektin e mëparshëm, ju lutemi vizitoni faqen e internetit: <https://www.hdcentre.org>

përmbajtjen që është bërë publike në media sociale, meqë projekti është realizuar me një numër të kufizuar monitoruesish, për shkak të vëllimit të madh të angazhimit. Prandaj, këto gjetje paraqesin një pasqyrë të përgjithshme të çështjeve dhe trendeve që janë hasur në zgjedhjet lokale 2021, me shumë mësim të nxjerra dhe rekomandime që duhen marrë në konsideratë në të ardhmen.

Grupi realizues ka përdorur një sërë matjesh cilësore në vlerësimin e shkeljeve të raportuara nga njësia e monitorimit. Megjithatë, ky raport duhet të lexohet me kuptimin se palë të ndryshme të interesuara, entitete ose persona të tjerë mund të kenë interpretime të ndryshme nëse një përmbajtje a pjesë e saj plotëson pragun për t'u konsideruar si shkelje (p.sh. gjuhë urrejtjeje ose dezinformatë). Prandaj, është plotësisht e mundur të kemi pikëpamje të ndryshme për gjetjet e paraqitura në këtë raport.

Legjislacioni zgjedhor nuk parasheh përkufizim të gjuhës së urrejtjes, ndonëse ekzistojnë dispozita të përgjithshme që e ndalojnë atë. Për shembull, gjatë periudhës së fushatës subjektet politike, mbështetësit e saj apo kandidatët e tjerë ndalohen nga "përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë."²

Aktet e ndaluara janë të përfshira më tej në Kodin e Sjelljes për Subjektet Politike, Kandidatët dhe Përkrahësit e tyre, i miratuar edhe si Rregullore (11/2013) nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Disa shembuj të akteve të ndaluara me kodi të sjelljes përfshijnë: shkatërrimin e materialeve të partive të tjera, shpërndarjen e takimeve të partive të tjera, pengimin e gazetarëve në kryerjen e funksioneve të tyre, premtimin e shpërblimeve financiare për të fituar mbështetjen e votuesve.³ Janë një sërë aktesh të tjera të ndaluara me ligj zgjedhor, të cilat, nëse kryhen, mund të sanksionohen në bazë të ankesave nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.⁴

Dispozita të ndryshme kundër diskriminimit ekzistojnë edhe në ligjin për kundër diskriminimit, ligjin për barazi gjinore dhe ligjin për mbrojtjen ose të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. Megjithatë, ka hapësirë të konsiderueshme për t'i adresuar boshllëqet ligjore në ligjin zgjedhor ose kodin e sjelljes në të ardhmen, duke i pasur parasysh vështirësitë e reja lidhur me përmbajtjet negative në mediat sociale.

² Ligji për zgjedhjet e përgjithshme, neni 33 (l)

³ Për më shumë informata, shih rregulloren (11/2013) e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, neni 4


⁴ Për më shumë informata, shih rregulloren (11/2013) e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, neni 9

Metodologjia

Fushëveprimi i monitorimit

Monitorimi u fokusua në shkallën në të cilën partitë politike, kandidatët, mediat dhe OJQ-të i respektuan zotimet e dhëna me nënshkrimin e deklaratave. Në monitorim përfshihen edhe partitë politike dhe subjektet e tjera që nuk kanë nënshkruar kodin e mirësjelljes.

Monitorimi ka përfshirë të gjitha 38 komunat e Kosovës. Përderisa monitorimi shqyrtonte përdorimin e mediave sociale nga të gjitha palët, monitoruesit i kushtuan vëmendje edhe përmbajtjes së mediave sociale që kishin të bënin me komunitetet joshumicë, gratë dhe grupet e tjera të cenueshme.



Platformat e mediave sociale që janë monitoruar përfshinë, mes tjerash: Facebook, Instagram, Twitter, TikTok, Youtube, Uebfaqe/Blogje, Viber/Whatsapp. Monitorimi mbuloi të gjitha reklamat dhe përmbajtjet politike dhe zgjedhore të palëve të treta, mbështetësve dhe aktorëve të tjerë, në formë transmetuese dhe të shkruar, duke përfshirë postimet, deklaratat, përgjigjet dhe çdo formë tjetër komunikimi. Është përdorur edhe programi CrowdTangle, si mjet për identifikimin e storieve, performancave në media sociale, përkundër kufizimeve për sa i përket të dhënave që mund të gjurmohen.⁵

⁵ Shtojca A, faqe 23 e raportit.

Përmbajtja që u monitorua buron nga legjislacioni i Kosovës, përfshirë ligjet që kanë të bëjnë me zgjedhjet, kodi i mirësjelljes për partitë politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre, si dhe ligji kundër diskriminimit. Lloji i përmbajtjes së monitoruar përfshinte: gjuhë të urrejtjes, gjuhë degraduese, lajme të rreme, dezinformata, si dhe përmbajtje të tjera shpifëse ose keqdashëse që u vlerësuan si dëmtuese për mjedisin zgjedhor. Një kufizim i analizës është se ishte e pamundur të sigurojë mostër plotësisht përfaqësuese të incidenteve.⁶

Njësia e monitorimit

D4D krijoi një mekanizëm monitorues të përbërë nga 10 studentë të trajnuar të gazetarisë (në tekstin e mëtejme "monitorues") të cilët ishin përgjegjës për monitorimin e zotimeve të partive politike, kandidatëve, mediave dhe OJQ-ve. Monitoruesit ishin përfaqësues dhe përfshirës të të gjitha komuniteteve etnike në Kosovë dhe janë caktuar për të monitoruar rajone specifike dhe parti politike dhe kandidatë specifike. Monitoruesit kanë monitoruar periudhën zgjedhore nga momenti i fillimit të fushatës deri në shpalljen e rezultateve, si në raundin e parë ashtu edhe në atë të dytë të zgjedhjeve (nga 16 shtator deri më 15 tetor, në raundin e parë, si dhe nga 3 deri më 12 nëntor, në raundin e dytë).

Përveç monitoruesve, projekti inkurajoi aktivisht palët e interesuara dhe qytetarët që të monitorojnë përmbajtjen në mediat sociale dhe të raportojnë çdo vërejtje apo ankesë në organet përkatëse të ankesave zgjedhore. Kjo është bërë përmes thirrjeve të postuara në faqen e D4D në media sociale dhe përmes postimit të infografikave gjatë fushatës. Është hapur një email i veçantë i D4D për grumbullimin e raportimeve dhe dëshmime të shkeljeve të kryera. Votuesit dhe akterët e tjerë u ftuan t'i raportojnë përmbajtjet e padëshirueshme. Janë inkurajuar edhe raportime nga akterët si partitë, kandidatët, mediat dhe OSHC-të.

Sigurimi i cilësisë

Stafi i mediave sociale të HD-së mbajti trajnime për monitoruesit, si të realizohet monitorimi, mjetet dhe teknikat e monitorimit, dhe si të gjykojmë për përmbajtjen që marrim ose raportojmë. Trajnimi gjithashtu pajisi mbledhësit e të dhënave me njohuri rreth Standardeve të Komunitetit të Facebook dhe Politikave të Reklamimit. Menaxherët e lartë të programit të D4D dhe trajnuesit e projektit ofruan udhëzime të përditshme për monitoruesit dhe siguruan kontroll cilësor të raportimeve të pranuar. Gjithashtu,

⁶ Gjatë zgjedhjeve komunale të vitit 2021, partitë dhe kandidatët u mbështetën kryesisht në mediat sociale për të zhvilluar fushatën e tyre, gjë që rriti sasinë e përmbajtjeve të postuara dhe të shpërndara përmes mediave sociale. Ky ishte pilot-projekt, dhe me vetëm 10 monitorues nuk ishte e mundur të monitorohej secila parti, kandidat apo mbështetës në mediat sociale. Megjithatë, ekipi i projektit bëri të pamundurën për të kapur përmbajtjen kryesore dhe për t'i identifikuar trendet dhe gjetjet që do të mund të informonin një projekt të ardhshëm.

monitoruesit janë kërkuar ta kontrollojnë sërish raportimin, si dhe të kryejnë verifikim të burimit të informacionit dhe t'i ekzaminonjë provat.

Të dhënat nga monitorimi janë mbledhur në një bazë të përbashkët të dhënash, e cila përfshinte një vegëz të burimit apo provën e çdo shkeljeje të raportuar. Baza e të dhënave përditësohej çdo ditë me raportimin e shkeljeve të reja dhe u zbatuan masa integriteti për të siguruar që dokumentohej çdo shkelje.

Angazhimi i palëve të interesuara

Në muajin gusht 2021, D4D organizoi disa diskutime në fokus grupe me parti politike, media, organizata të shoqërisë civile dhe komisione zgjedhore për t'i identifikuar çështjet prioritare dhe për t'i diskutuar zotimet e deklaratës. Gjetjet nga fokus grupet u përdorën për të hartuar metodologjinë e monitorimit dhe për t'i hartuar deklaratat që u nënshkruan më vonë.

D4D organizoi një [Ceremoni të nënshkrimit](#) për Deklaratën e Mirësjelljes në Mediat Sociale gjatë zgjedhjeve lokale 2021, e cila mori edhe [shpërndarje globale](#) nga Qendra HD. Në ceremoni morën pjesë përfaqësues të partive politike, mediave, shoqërisë civile dhe akterëve të tjerë zgjedhorë. Kodin e mirësjelljes nuk e nënshkruan të gjitha partitë që garuan në zgjedhje, por, megjithatë, e nënshkruan disa nga partitë kryesore politike në koalicionin qeveritar dhe opozitë.




Gjetjet kryesore


Të përgjithshme

Njësia monitoruese ka raportuar gjithsej 197 shkelje të cilat kanë ndodhur në 27 komuna në të gjitha rajonet e Kosovës. Komunat me përqindjen më të lartë të shkeljeve të raportuara ishin: Prishtina (31%), Prizreni (9%) dhe Gjakova (8%). Në këto komuna rreziku ishte i lartë dhe konkurrenca e ndezur, meqë në të tri komunat u mbajtën zgjedhjet e raundit të dytë dhe dallimi i fitores ndërmjet kandidatit të parë dhe të dytit ishte relativisht i vogël. Shkelje janë raportuar edhe në komunat me shumicë serbe duke përfshirë Mitrovicën e Veriut (6%), Kllokotin (3%) dhe Graçanicën.


Grafi 1. Proporcioni i shkeljeve të raportuara, sipas komunës




Shumica e shkeljeve të raportuara kanë ndodhur në periudhën para raundit të parë të zgjedhjeve (16 shtator deri 15 tetor 2021). Kjo mund të jetë për shkak të numrit më të madh të kandidatëve, përfshirë kandidatët që garojnë në zgjedhje për kuvende komunale, në krahasim me raundin e dytë ku përqindja e shkeljeve të raportuara pësoi rënie të ndjeshme. Shumica e shkeljeve të raportuara (53%) kanë ndodhur dy javë para ditës së zgjedhjeve në raund të parë, edhe pse një numër i konsiderueshëm i shkeljeve (5%) është vërejtur edhe gjatë periudhës së heshtjes dhe ditës së zgjedhjeve (16-17 tetor 2021) të raundit të parë. Tensionet u ulën pas raundit të parë të zgjedhjeve dhe pastaj u rritën sërish në periudhën para zgjedhjeve të raundit të dytë (1 – 12 nëntor, 17%).

Grafi 2. Shkeljet e raportuara, sipas periudhës kur kanë ndodhur

Gati dy të tretat e shkeljeve të raportuara kishin të bënin me përdorimin e gjuhës së urrejtjes (62%). Shkeljet e tjera të regjistruara ishin në formë të dezinformatës (4%), memeve (4%), lajmeve të rreme (3%), informatave jashtë kontekstit (2%) dhe ngacmimeve personale (2%). Ka qenë edhe një numër i konsiderueshëm i shkeljeve të tjera (5%), si përdorimi i fëmijëve gjatë fushatës, thyerja e periudhës së heshtjes, si dhe shkelje të tjera në kuadër të Kodit të Mirësjelljes, të cilat janë vërejtur edhe për qëllime të këtij raporti.

Grafi 3. Proporcioni i shkeljeve të raportuar, sipas llojit të shkeljes

Për sa i përket subjekteve që kanë kryer shkeljet, më shumë se gjysma e shkeljeve të raportuara kanë qenë nga partitë politike (27%), ose nga kandidatët individualë (25%) që garonin në zgjedhje. Një përqindje e konsiderueshme është shkaktuar edhe nga mediat (34%) dhe mbështetësit e partive (8%). Shumë pak shkelje janë regjistruar nga burime të pidentifikuara, llogari të palëve të treta dhe OJQ-të.

Grafi 4. Proporcioni i shkeljeve të raportuara, sipas shkelësit të pretenduar

Të dhënat tregojnë se partitë politike që pretendohet se kanë bërë shkeljet më të shumta e që gjithashtu ishin më së shumti në shënjestër të përmbajtjeve negative, si gjuha e urrejtjes, dezinformata, gjuha shpifëse, etj. Të dhënat tregojnë se partitë me më së shumti


Më shumë se gjysma e shkeljeve të raportuara të bëra nga partitë dhe kandidatët

Kosovës (16%).

Të dhënat tregojnë se partitë politike më së shumti të shënjestruara ishin VV, e cila prin me afro dy të tretat (67%), vijuar nga AAK (14%), LDK (11%) dhe PDK (6%). Siç do të shohim tutje në raport, arsyeja pse VV ishte më së shumti në shënjestër është për shkak se një pjesë e konsiderueshme e shkeljeve të kryera nga ana e mediave apo analistëve të medias kishin si objekt kandidatët e VV-së. Si partia që fitoi më shumë se 50% të votave popullore në zgjedhjet e përgjithshme të mbajtura në muajin shkurt 2021, VV është gjithashtu partia që qeveris në nivel qendror dhe prandaj kandidatët e saj pranuan më së shumti vëmendje nga mediat dhe akterët e tjerë.

shkelje të raportuara ishin Vetëvendosje! (32%), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (27%), vijuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (17%) dhe Partia Demokratike e


Grafi 5. Shkelësit e raportuar (parti politike) kundrejt partive të shënjestruara



Ekipi monitorues realizoi një monitorim të një numri platformash në media sociale, duke përfshirë Facebook, Youtube, Twitter, Instagram, faqe të internetit dhe platforma të tjera të bisedës si Viber dhe WhatsApp. Aktiviteti i fushatës së partive politike u përqendrua dhe u realizua kryesisht në platforma interneti, pjesërisht edhe si masë e mbrojtjes së publikut kundër pandemisë Covid-19.


Përqindja më e madhe e shkeljeve të raportuara ishin në Facebook (76%), ndjekur nga Youtube (18%) dhe faqe të interneti (4%) – me këtë të fundit veçanërisht relevante për portalet e mediave në internet. Të dhënat në këtë grafik nuk nënkuptojnë se shkeljet e postuara në një media sociale (p.sh. Facebook) nuk janë postuar edhe në platforma të tjera të mediave sociale. Të dhënat tregojnë vetëm mediat sociale në të cilat monitoruesit e kanë parë përmbajtjen. Nga shkelje e kryera, Facebook mbetet platforma ku është prodhuar dhe shpërndarë pjesa më e madhe e përmbajtjeve negative, meqë edhe është platforma më e përdorur në Kosovë, me 1.1 milionë përdorues aktivë në muaj. Shumica e shkeljeve në Youtube i përkasin debateve të drejtpërdrejta mediatike mes kandidatëve, të transmetuara në Youtube.

Grafi 6. Proporcioni i postimeve me gjuhë të urrejtjes, sipas rrjeteve sociale



Për sa i përket formatit përmes të cilit janë postuar shkeljet në media sociale, forma kryesore e shkeljes është forma e shkruar (42%), vijuar nga ajo në video ose debatet mediatike (37%) të transmetuara në internet dhe postimet që përfshijn një fotografi (17%). Një kufizim ishte se projekti nuk ishte në gjendje të monitoronte komentet të cilat përbënin një përqindje të ulët për sa i përket shkeljeve të raportuara në këtë raport, por

megjithatë mbesin forma më e zakonshme e shprehjes për përmbajtje negative. Në të ardhmen duhet t'i kushtohet vëmendje monitorimit të komenteve në media sociale, gjë që kërkon alokim më të madh të burimeve dhe monitoruesve në të gjitha komunat.



Partitë politike dhe kandidatët

Ligji për zgjedhjet e përgjithshme përcakton që “Të gjitha subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe të gjitha institucionet tjera janë të obliguara të respektojnë parimet themelore të përcaktuara në këtë nen dhe të ndërmarrin të gjitha masat për të siguruar mbajtjen e zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të mirë-informuara në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.”⁷

Gjatë periudhës së fushatës subjektet politike, mbështetësit e saj apo kandidatët e tjerë ndalohen nga “përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë.”⁸

Siç u theksua edhe më parë në këtë raport, partitë politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre përbëjnë shumicën e shkeljeve të evidentuara si pjesë e monitorimit të kryer në kuadër të këtij projekti. Kjo pjesë e raportit paraqet vetëm disa nga shkeljet ilustruese të përzgjedhura të përdorura nga liderë, kandidatë apo anëtarë të partive të ndryshme politike gjatë fushatës.

⁷ Ligji për zgjedhjet e përgjithshme, neni 32

⁸ Ligji për zgjedhjet e përgjithshme, neni 33 (l)

Në një debat televiziv mes kandidatëve që garonin në Kamenicë, kandidati i Vetëvendosjes përdori fjalë shpifëse ndaj kandidatit tjetër:

Deklarata është përsëritur së paku tri herë gjatë këtij debati nga kandidati i VV-së.

Kjo tregon ftyrën e ketij mjerani



Edhe pse vetë lideri i AAK-së nuk ishte kandidat në këto zgjedhje, ai u citua në shumë raste duke përdorur gjuhë urrejtjeje apo gjuhë degraduese. Së paku në një rast, liderët e AAK-së deklaruan:



Albini është hajn



Akuza të tilla, të cilat janë të zakonshme edhe nga partitë e tjera, janë bërë pa asnjë provë apo informacion që do të kërkonte hetim të mëtejshëm për këtë çështje.

Lideri i partisë NISMA përdori edhe gjuhë urrejtjeje në një nga deklaratat e bëra.



**qyqana, të padijshëm,
fëmijë në qeverisje**



Siç vërehet, në një nga platformat mediatike është nënvizuar deklarata e kreut të NISMA-së. Në disa raste, kjo media përforconte gjuhën e urrejtjes së përdorur nga politikanët, duke përzgjedhur fjalë kyçe dhe duke i nënvizuar ato.

Një tjetër deklaratë është bërë nga një deputet (ish kandidat i Listës Vjosa në emër të listës së VV-së), i cili deklaroi:

“**Sahanlëpirës e mashtrues i pakurriz je kur [....] Sa poshtë ju ka ra katundi disa Lugovistave [...] Shkoni hani e lëpini bashkë [...]**



Në këtë rubrikë janë paraqitur së paku tri forma të dukshme të sulmit ndaj kandidatit të LDK-së, i cili është zgjedhur kryetar i Kryeqytetit të Prishtinës. Në të majtë është një lajm i rremë se kandidatura e Përparim Ramës mund të refuzohet për shkak se ai aplikoi për certifikim me letërnjoftim të UNMIK-ut (dokument identifikues që më nuk është në përdorim). Fotografia në mes tregon një formë të fushatës negative përmes deklaratës ironike të kundërkandidatit se Përparim Rama do ta rrënojë Pallatin e Rinisë dhe Sporteve. Në të djathtë është përdorimi i gjuhës nënçmuese dhe shpifëse.



Përparim Rama, Foto: Facebook

Kandidati i LDK-së për Prishtinën, aplikoi për certifikim në KQZ me letërnjoftim të UNMIK-ut



Masi nuk tha që sheshi Adem Jashari ka me pas pamje ka liqeni

Sulme janë bërë edhe ndaj kandidatit të VV-së në Prishtinë, duke përfshirë publikimin e lajmeve të ndryshme të paverifikuara me pretendime për skandale seksuale. Siç tregojnë të dhënat, Kryeqyteti i Prishtinës ka pasur një garë relativisht të nxehtë dhe rreth një e treta e shkeljeve të raportuara janë bërë në Prishtinë.

Në një debat televiziv mes kandidatëve për kryetar të Komunës së Drenasit, kandidati për kryetar nga radhët e PDK-së deklaroi:

“O hut mashtrues

‘O hut’, ‘mashtrues’, Lladrovci kapet keq me kandidatët e tjerë të Drenasit

admin October 2, 2021



Një formë tjetër e gjuhës së urrejtjes është përdorur një deputet i LDK-së, i cili në një koment sulmoi dy kandidatë të Lëvizjes Vetëvendosje. Deputeti i LDK-së i është kundërpërgjigjur një deklaratë kundër kandidatit të VV-së në Podujevë, dhe duke përdorur gjuhë nënçmuese ndaj tij e quajti sharlatan si Agim Bahtiri.

“Sharlatan Agim Bahtiri of Llapi

Meta për Shpejtim Bulliqin: Ky Agim Bahtiri i Llapit, s’la personalitet ilapjan pa e sha

21/10/2021 | 15:23



Mediat

Siç u përmend më herët në këtë raport, rreth një e treta (34%) e shkeljeve të raportuara janë bërë nga media. Shkeljet nga mediat zakonisht kanë ndodhur për shkak se analistët, redaktorët dhe opinionistët aktualë ose të mëparshëm në media përdornin gjuhë të urrejtjes, gjuhë shpifëse ose nënçmuese ndaj disa partive politike ose kandidatëve, ose publikimit të lajmeve të paverifikuara që tregojnë indikacione të paragjykitimit në pikëpamjet e tyre.

Një dezinformatë e madhe mediale kishte të bënte me një billboard në komunën e Prizrenit. Një numër i madh mediash publikuan një fotografi të prerë të kryeministrit Albin Kurti (shih fotografinë djathtas), ku thuhej se kandidati komunal i Prizrenit po përdor fotografinë e kryeministrit për fushatën e tij. Kjo më vonë u sqarua, pasi në billboard u shfaqën dy imazhe, ai i kryetarit të komunës së Prizrenit dhe liderit të VV-së.

Shumë media dhe analistë nxituan të publikonin dezinformatat pa verifikuar dizajnin/fotografinë e billboardit në këtë rast.

Postimi:



Realiteti:



Monitoruesit raportuan një numër shkeljesh të bëra nga analistë të mediave, redaktorë dhe opinionistë, përfshirë Valon Sylën, Berat Buzhalën dhe Milaim Zekën, të cilët janë raportuar në raste të shumta se postonin përmbajtje që klasifikoheshin si gjuhë e urrejtjes ose gjuhë nënçmuese.



Në një rast, për shembull, Valon Sylë citohet të ketë shkruar: "Albin Kurti është gënjeshtar, budalla dhe është regjistruar edhe si veteran i rremë, me ndihmën e disa komandantëve të retarduar". Në bazën e të dhënave u evidentuan një sërë citatesh të tjera të këtij lloji, të shprehura në formë të postimit, postimi me fotografi, ose pjesëmarrje në debat mediatic. Në disa raste, këta gazetarë citonin ose ndanin postimet e njëri-tjetrit.

Është tejet shqetësuese që mediat janë të vetëdijshme për shkeljet që bëhen nga analistë të medias - dhe ata rrallëherë humbasin mundësinë për të përdorur gjuhë të urrejtjes ose gjuhë shpifëse për të sulmuar figura politike - dhe megjithatë mediat ofrojnë mundësi dhe hapësirë për analistë që t'i shprehin këto pikëpamje.

Në raste të tjera, mediat kryen shkelje jo duke shprehur pikëpamjet e tyre, por duke cituar dhe nënvizuar gjuhën shpifëse ose nënçmuese të paraqitur nga liderët politikë, kandidatët apo mbështetësit e tyre. Është e rëndomtë që mediat të nënvizojnë frazat të

cilat përforcojnë pikëpamjet e paraqitura para audiencës. Për më tepër, media shpeshherë 'kapin' pjesë të caktuara të debateve televizive në të cilat debati është aq i ndezur sa kandidatët përdorin gjuhë të urrejtjes kundër njëri-tjetrit dhe i paraqesin këto video-segmente si pika kryesore e videos në mënyrë që të gjenerojnë më shumë shikueshmëri.

Shkeljet e raportuara me bazë gjinore

Vetëm 12 nga 158 (8%) kandidatë për kryetar komune në 38 komunat e Kosovës ishin gra. Gratë vazhdojnë të jenë të nënparaqesura në listat e kandidatëve për kryetarë komunash që emërohen nga partitë politike, dhe janë një sërë pengesash me të cilat ato vazhdojnë të përballen për sa i përket përfaqësimit dhe pjesëmarrjes politike në Kosovë.

Edhe pse numri i grave kandidate për kryetar komune është i ulët, gjuha e urrejtjes, gjuha shpifëse dhe poshtëruese ishte dukuri e zakonshme ndaj grave që morën pjesë si kandidate në zgjedhje.

Një nga gratë kandidate më së shpeshti në shënjestër ishte Mimoza Kusari Lila, e cila ishte gruaja e vetme e zgjedhur kryetare e komunës në Kosovë, për një mandat në Gjakovë. Në një debat të drejtpërdrejtë televiziv të kandidatëve për Kryetar të Komunës së Gjakovës, kandidati i AAK-së shprehi një sërë deklaratash fyese:

“ Uau, cfare turreci, lem ta perfundoj nje fjali [...] bile ty s’duhet me te nxan bese se kushedi cka bon apet se krejt i ke ndrru



Në një video tjetër të postuar në Facebook, një deputete grua (VV) shfaq përkrahjen e saj për Mimoza Kusari Lilën teksa këndon në Facebook. Janë evidentuar një mori fyerjesh në baza gjinore dhe gjuhë nënçmuese ndaj të dy grave.

Në një deklaratë, kandidati i AAK-së për Komunën e Istogut deklaroi si në vijim:

“ Pastruesja eshte me drejtor se drejtori



Një shkelje tjetër e raportuar është ajo nga ish kryetari i komunës së Prizrenit nga radhët e VV, i cili në mbledhjen e Kuvendit Komunal të Prizrenit bëri deklaratë fyese si kundërpërgjigje ndaj një deklaratë të mëparshme të një gruaje anëtare të kuvendit komunal.

Në një video tjetër që tani nuk gjendet në internet, një analiste mediatike pyet një nga kandidatet gra që garonin për kryetare komune: "Si është të konkurrosh duke e ditur se nuk do të fitosh". Ndonëse kjo mund të mos kualifikohet si gjuhë urrejtjeje, sigurisht që paraqet një deklaratë degraduese në baza gjinore.



Rruqaqeve të cilat shpifin dhe genjejne [...]



Shkeljet e raportuara me bazë etnike

Ka pasur një numër shkeljesh të raportuara me relevancë etnike, si në aspekt të marrëdhënieve brenda komuniteteve ashtu edhe ndërmjet komuniteteve në Kosovë. Në pjesën më të madhe, mjedisi i mediave sociale gjatë fushatës, veçanërisht në raport me komunitetin shqiptar dhe atë serb të Kosovës, u ndikua dukshëm nga ngjarjet në lidhje me targat.

Qeveria e Kosovës vendosi masën e reciprocitetit, me të cilën kërkohet që automjetet që hyjnë në Kosovë me targa serbe të marrin targa të përkohshme, masë të cilën qeveria e Serbisë e ka vendosur prej vitesh për hyrjen e automjeteve të Kosovës në Serbi. Gjersa kjo ngjarje nuk është medoemos e lidhur me zgjedhjet komunale, megjithatë nxiti shqetësime të mëdha sigurie gjatë fushatës.

Në përgjigje të masës, serbët në komunat veriore të Kosovës vendosën postbllloqe në rrugët që çojnë për në pikat e kontrollit kufitar. Qeveria e Kosovës dërgoi njësinë speciale policore në komunat veriore të Kosovës, ndërsa qeveria e Serbisë vendosi ushtrinë dhe tanket e saj pranë kufirit me Kosovën. Pas një pezullimi disaditor, më 30 shtator (rreth dy javë para zgjedhjeve) Kosova dhe Serbia arritën një marrëveshje të ndërmjetësuar nga BE. Ndonëse kjo ngjarje nuk është në kuadër të këtij hulumtimi, duhet theksuar se ajo ndodhi gjatë periudhës zgjedhore dhe është manifestuar në urrejtje të shprehur në mediat sociale ndërmjet komuniteteve në Kosovë.



Albin Kurti
Sep 25, 2021 · 🌐

Në bllokimet e rrugëve magjistrale që shpiejnë në drejtim të vendkalimeve kufitare Jarinje dhe Bërnjak po marrin pjesë individë të dëshmuar me veprimtari kriminale e pikëpamje ekstremiste. Në vijim janë dhënë përshkrimet dhe fotografitë e dy prej tyre.

1. Vladislav Dajković, shtetas malazez, me datë... See More



Për shembull, kur u dërguan njësitet e policisë së Kosovës në përgjigje të bllokimeve të rrugëve, një numër i [videove](#) u shpërndanë në internet nga protestuesit serbë që ofendonin policinë e Kosovës me gjuhë ofenduese, degraduese dhe fyese duke vënë në dyshim statusin, zotësinë dhe pamjen e tyre.

Në një rast tjetër, Kryeministri i Kosovës postoi një fotografi në të cilën pretendohet se persona të caktuar [në fotografi] me pikëpamje ekstremiste janë përfshirë në aktivitete kriminale dhe kanë marrë pjesë në postblloqe në pikën kufitare Jarinje dhe Bërnjak. Një nga individët e etiketuar në këtë postim, u përgjigj: “[...] ditët e fundit kam marrë qindra, madje dhe mijëra, kërcënime brutale me vdekje nga disa shqiptarë nga Kosova dhe Metohia”.

Një përfaqësues i Listës Serbe citohet të ketë thënë “serbët e Kurtit” duke iu referuar çdo serbi që nuk e përkrah Listën Srpska sikur të ishte i kryeministrit Kurti.

Një numër portalesh të mediave serbe cituan politikanë serbë në Serbi duke përdorur gjuhë të urrejtjes kundër politikanëve në Kosovë. Për shembull, në raste të shumta, zyrtarë të qeverisë serbe u cituan ta kenë quajtur Kurtin “psikopat”, “përkrahës të terrorizmit” dhe, në një rast, duke i bërë thirrje KFOR-it/NATO-s që ta “frenojnë” atë.



Përfundime

Qëllimi i këtij pilot-projekti ishte të paraqesë një pasqyrë të përgjithshme të çështjeve dhe trendeve në mediat sociale gjatë zgjedhjeve lokale 2021, me shumë mësim të nxjerra dhe rekomandime për t'u marrë parasysh në të ardhmen. Gjetjet e këtij raporti paraqesin një përmbledhje të përgjithshme e përfaqësuese të përmbajtjes së mbuluar nga njësia e monitorimit (197 shkelje të raportuara), por mund të mos përfshijë tërë përmbajtjen që është bërë publike në media sociale.

Janë një sërë përfundimesh që mund të nxirren nga të dhënat e monitorimit dhe nga seminarët konsultative të mbajtura me partitë politike, mediat, organizatat e shoqërisë civile dhe komisionin zgjedhor.

- 1 |** Lajmet e rreme, gjuha e urrejtjes dhe përmbajtjet e tjera keqdashëse janë të pranishme në mediat sociale në Kosovë dhe janë problematikë në rritje që duhet adresuar. Në takimet konsultative partitë politike, mediat dhe OSHC-të përgjithësisht shprehën pikëpamjen se përmbajtjet e tilla kanë ndikim negativ në mjedisin zgjedhor dhe kanë potencial të ndikojë në sjelljen e administratës dhe në rezultatin e zgjedhjeve. Nevojitet një qasje shumëpalëshe, nga partitë politike, kandidatët, mediat, shoqëria civile dhe komisioni zgjedhor, për t'i zbatuar zotimet e deklaratës dhe për të luftuar përmbajtjet e tilla.
- 2 |** Partitë politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre janë furnizuesit kryesorë të përmbajtjes negative në media sociale, në aspekt të krijimit, publikimit por edhe shpërndarjes së përmbajtjes. Kjo bëhet në një sërë mënyrash, siç janë deklaratat mediatiqe, postimet në faqe zyrtare të mediave sociale, ose shpërndarja e përmbajtjes përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit (Viber, WhatsApp etj.). Shumica e përmbajtjes prodhohet drejtpërdrejt nga partitë dhe kandidatët, dhe jo nga llogarive apo bote të palëve të treta.
- 3 |** Portalet e mediave dhe analistët krijojnë ose përforcojnë përmbajtje negative. Raporti ka treguar një sërë rastesh kur gazetarë, analistë apo reporterë të njohur kanë përdorur gjuhë të urrejtjes ose gjuhë degraduese kundër partive politike, kandidatëve dhe aktorëve të tjerë. Raporti gjithashtu ka treguar se mediat kanë tendencë që tërthorazi të përforcojnë përmbajtje negative, veçanërisht duke nënvizuar, shfaqur dhe sponsorizuar pjesë të caktuara të gjuhës së urrejtjes të deklaruara nga partitë politike dhe kandidatët e tyre.
- 4 |** Partitë që prodhojnë më shumë urrejtje edhe pranojnë më shumë urrejtje. Brenda kufizimeve të theksuara në raport, të dhënat tregojnë se VV dhe AAK, të cilat ishin partitë që kanë prodhuar më së shumti përmbajtje negative, ishin edhe partitë që më së shumti kanë qenë në shënjestër nga të tjerët. Të gjitha partitë e tjera të mëdha dhe kandidatët e tyre janë raportuar të kenë bërë shkelje.

-
- 5 |** Gjuha e urrejtjes me bazë etnike ndikohet nga politika e nivelit qendror. Edhe pse zgjedhjet komunale të vitit 2021 qëllim e kishin zgjedhjen e kryetarëve të komunave dhe kuvendeve komunale, te kandidatët që ishin në ballë të garës zgjedhore, nga këndvështrimi i marrëdhënieve etnike, gjatë periudhës së fushatës dominoi diskursi mbi targat, që në vete është vetëm një pjesë e problemi më të gjerë të mosmarrëveshjeve midis Kosovës dhe Serbisë.
- 6 |** Shkeljet e mediave sociale përforcojnë patriarkalitetin tradicional në shoqëri: përkundër numrit të ulët të grave kandidate, sulmet ndaj grave kandidate ishin të konsiderueshme. Gratë vazhdojnë të jenë të nënperfaqësuara në listat e kandidatëve dhe përballen me barriera në përfaqësim dhe pjesëmarrje politike. Në vend që t'i inkurajojnë, promovojnë dhe mbështesin gratë kandidate, partitë politike diskriminojnë gratë kandidate të partive të tjera në bazë të aftësive, statusit social dhe pamjes së tyre. Fyerjet ndaj grave janë përforcuar edhe nga disa media, qoftë përmes analistëve që promovojnë gjuhë të urrejtjes, qoftë duke cituar kandidatë politikë që bënin deklaratë kundër grave, duke përforcuar disa nga përmbajtjet negative të disponueshme në internet.
- 7 |** Në përgjithësi, përhapja e gjuhës së urrejtjes, dezinformimit, lajmeve të rreme dhe ngacmimeve personale në mediat sociale ka potencial të dëmtojë mjedisin zgjedhor, të ndryshojë rezultatin e zgjedhjeve dhe të ndikojë në procesin demokratik. Këto çështje duhet të trajtohen me prioritet në mënyrë që diskursi i tillë të mos inkurajohet, përdoret apo promovohet në publik.

Rekomandime

Janë një sërë rekomandimesh që duhen marrë parasysh për të ardhmen:

- 1** | Kodi i mirësjelljes për partitë politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre duhet të zgjerohet për të përfshirë dispozita që ndalojnë lajmet e rreme, dezinformatat, gjuhën e urrejtjes dhe format e tjera të përmbajtjes negative të përfshira në këtë raport.
- 2** | Ligji zgjedhor duhet t'ia sigurojë çdo votuesi, kandidati apo partie politike mundësinë ligjore që të parashtrojë ankesë për shkelje dhe, në bazë të pranueshmërisë dhe meritës, të shqiptohen ndëshkime dhe gjopa kundër partive politike dhe kandidatëve.
- 3** | Partitë politike duhet t'i orientojnë kandidatët dhe mbështetësit e tyre gjatë periudhës zgjedhore, ashtu që të distancohen nga kandidatët që prodhojnë përmbajtje negative në media sociale dhe të marrin masa adekuate kundër çdo anëtarit të partisë së tyre që përdor urrejtje për të diskriminuar në baza etnike, gjinore ose statusi social. Gjithashtu, partitë politike duhet të vetërregullohen, të shmangin postimet ose promovimet e përmbajtjeve negative, të distancohen nga kandidatët që e bëjnë këtë dhe të heqin ose zbehin përmbajtjen e padëshirueshme.
- 4** | OSHC-të duhet të vazhdojnë t'i monitorojnë partitë politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre, shkallën në të cilën ata zbatojnë zotimet e deklaratës (përfshirë në pozitë të zgjedhur), dhe shkallën në të cilën e bëjnë financimin e reklamave në media sociale të hapur dhe transparent.
- 5** | Këshilli i Mediave të Shkruara duhet të ofrojë trajnime për mediat, gazetarët dhe reporterët e tyre, mbi kodet e sjelljes që aplikohen për mediat, si dhe për sjelljen specifike në fushatë dhe zgjedhje.
- 6** | Trajnimet për edukim mediatik dhe të mediave sociale duhet të ofrohen si pjesë e projekteve të vazhdueshme zhvillimore ndërkombëtare dhe, aty ku është e mundur, këto duhet të institucionalizohen edhe në kuadër të sistemit formal arsimor, në shkolla dhe universitete.
- 7** | Të punohet me Facebook dhe kompanitë e tjera të mediave sociale dhe akterët kryesorë politikë dhe qeveritarë për të zhvilluar një regjim evektiv politikash që rregullon këtë diskurs në mediat sociale. Gjithashtu, të kontaktohet Facebook për të aktivizuar funksionin "Biblioteka e Reklamave" për Kosovën, meqë kjo do të rriste transparencën e financimit të postimeve të mediave sociale në Facebook.
- 8** | Rregullimi dhe vendosja e normave për përdorim të gjuhës së urrejtjes dhe dezinformatës – me hapa për të siguruar evoluim të normave dhe reformave – dhe me fokus jo në mënyrën se si të tjerët sulmojnë partinë tuaj por si zhvillohet ky diskurs, do të kufizojë demokracinë dhe do të rrisë mundësinë e konfliktit.

Shtojcat

Shtojca 1: Lista e palëve nënshkruese të deklaratës

Organizatrat joqeveritare

- Rinia Aktive e Graçanicës
- Demokraci Plus
- Instituti Kosovar për Drejtësi
- Zëri i Romëve, Ashkalinjëve, dhe Egjiptianëve
- Lëvizja FOL
- Demokraci për Zhvillim
- Instituti Demokratik i Kosovës
- NGO Aktiv

Mediat

- Këshilli i mediave të shkruara të Kosovës
- Telegrafi.com
- Ballkani.info
- Kosoalive

Partitë politike

- Aleanca Kosova e Re
- Lëvizja Vetëvendosje
- NISMA Socialdemokrate
- Partia Demokratike e Kosovës
- SDU
- Iniciativa Qytetare "GREEN" për Drenasin
- Lidhja Demokratike e Kosovës

Shtojca 2: Deklaratë për partitë politike dhe kandidatët

DEKLARATË

për

MIRËSJELLJE TË PARTIVE POLITIKE NË RRJETET SOCIALE GJATË ZGJEDHJEVE LOKALE
2021

Parimet

Me qëllim të respektimit dhe zbatimit të duhur të ligjeve dhe rregulloreve zgjedhore,

Me qëllim të përmirësimit të mjedisit të fushatës zgjedhore të zgjedhjeve lokale të vitit 2021,

Me qëllim të respektimit të parimeve të mosdiskriminimit, informimit të saktë dhe mbrojtjes së privatësisë, dhe

Me qëllim të luftimit të përmbajtjes negative në rrjetet sociale,

Ne zotohemi se:

- Do të respektojmë ligjet zgjedhore, rregulloreve dhe kodeve të sjelljes për entitetet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre
- Do të sigurojmë që reklamat, pozitat dhe mesazhet e përçuara gjatë fushatës të mos kenë përmbajtje negative si gjuha e urrejtjes, lajmet e rreme, keqinformimi, dhe gjuha shpifëse
- Do të përdorim kanalet zyrtare për të komunikuar, dhe do të përmbahemi nga përdorimi i llogarive të palëve të treta dhe atyre të rreme
- Do të zbulojmë shpenzimet e realizuara për reklamat me pagesë në rrjetet sociale
- Do të bëjmë kritikë objektive dhe konstruktive kundrejt partive të tjera politike, kandidatëve dhe mbështetësve të tyre
- Do të kontrollojmë faktet dhe do t'i kushtojmë kujdes të duhur të gjitha informatave në fushatën politike.

Data:

Emri i Partisë Politike/Kandidatit/ Emri dhe Mbiemri:

Nënshkrimi:

Shtojca 3: Deklaratë për organizatat joqeveritare

DEKLARATË

për

MIRËSJELLJE TË ORGANIZATAVE JOQEVERIARE NË RRJETET SOCIALE GJATË ZGJEDHJEVE LOKALE 2021

Parimet

Me qëllim të respektimit dhe zbatimit të duhur të ligjeve dhe rregulloreve zgjedhore,

Me qëllim të përmirësimit të mjedisit të fushatës zgjedhore të zgjedhjeve lokale të vitit 2021,

Me qëllim të respektimit të parimeve të mosdiskriminimit, informimit të saktë dhe mbrojtjes së privatësisë, dhe

Me qëllim të luftimit të përmbajtjes negative në rrjetet sociale,

Ne zotohemi se:

- Do t'u ofrojmë mbështetje të gjithë hisedarëve për të zbatuar zotimet që dalin nga Deklarata për Mirësjellje në Rrjetet Sociale
- Do t'i monitorojmë rrjetet sociale dhe do të ndërmarrim veprime, do të hartojmë raporte dhe do të mbledhim reagime sipas nevojës për të luftuar përmbajtjen negative si gjuha e urrejtjes, lajmet e rreme, keqinformimi dhe gjuha shpifëse
- Do të kontrollojmë faktet dhe do t'i kushtojmë kujdes të duhur të gjitha informatave në rrjetet sociale
- Do të raportojmë dhe publikojmë rastet kur partitë politike, kandidatët ose mbështetësit e tyre ose palët e treta përdorin përmbajtje negative si formë reklamimi politik.

Data:

Emri i OJQ-së:

Nënshkrimi:

Shtojca 4: Deklaratë për mediat

DEKLARATË

për

MIRËSJELLJE TË ORGANIZATAVE MEDIALE NË RRJETET SOCIALE GJATË ZGJEDHJEVE
LOKALE 2021

Parimet

Me qëllim të respektimit dhe zbatimit të duhur të ligjeve dhe rregulloreve zgjedhore,

Me qëllim të përmirësimit të mjedisit të fushatës zgjedhore të zgjedhjeve lokale të vitit 2021,

Me qëllim të respektimit të parimeve të mosdiskriminimit, informimit të saktë dhe mbrojtjes së privatësisë, dhe

Me qëllim të luftimit të përmbajtjes negative në rrjetet sociale,

Ne zotohemi se:

- Do të respektojmë Kodin Etik të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe Kodin e Mediave të Shkruara të Kosovës
- Do të raportojmë dhe vlerësojmë korrektësinë faktike të reklamave politike dhe do t'i nxisim kolegët të jenë të vetëdijshëm për mesazhet e reklamave politike
- Do të sigurojmë që reklammat, qëndrimet dhe mesazhet e përçuara gjatë fushatës të mos kenë përmbajtje negative si gjuha e urrejtjes, lajmet e rreme, keqinformimi, dhe gjuha shpifëse
- Do të bëjmë kritikë objektive dhe konstruktive kundrejt kandidatëve dhe ekipeve të fushatës, partive politike, dhe fushatave politike
- Do të kontrollojmë faktet dhe do t'u kushtojmë kujdes të duhur të gjitha informatave në fushatat politike
- Do të sigurojmë cilësi redaktoriale që informatat e pasakta, të pavërteta, shpifëse dhe dashakeqe të mos publikohen

Data:

Emri i Medias:

Nënshkrimi:

Shtojca 5: Fjalorth i shprehjeve kryesore

Shprehjet në vijim janë nxjerrë nga Oxford Dictionary ose Merriam Webster dhe kanë kuptimin vijues në këtë raport:

Gjuha e urrejtjes	fjalim ose shkrim abuziv ose kërcënues që shpreh paragjykim kategorik kundër një grupi të caktuar, veçanërisht në bazë të racës, gjinisë, fesë ose orientimit seksual
Dezinformatë	informacione të rreme të shpërndara qëllimisht dhe shpeshherë fshehtëazi (siç është nisja e thashethemeve) me qëllim që të ndikojë në opinionin publik ose të turbullojë të vërtetën
Keqinformatë	informata të pasakta ose mashtruese
Meme	foto, video, etj. zbavitëse ose interesante, që përhapet gjerësisht në internet
Lajm i rremë	raporte të rreme të ngjarjeve, të shkruara dhe të lexuara në faqe të internetit

Shtojca 6: Skema e monitorimit

D4D krijoi një mekanizëm monitorues të përbërë nga 10 studentë të trajnuar të gazetarisë (në tekstin e mëtejshëm "monitorues") të cilët ishin përgjegjës për monitorimin e zotimeve të partive politike, kandidatëve, mediave dhe OJQ-ve. Ekipi monitorues përbëhej nga pjesëmarrës të komuniteteve shumicë dhe joshumicë nga të gjitha rajonet e Kosovës. Monitorimi është bërë në shqip dhe serbisht. Monitoruesit kanë punuar gjatë periudhës zgjedhore nga fillimi zyrtar i fushatës deri në certifikimin përfundimtar të rezultateve, pas përfundimit të raundit të dytë. Plani i shpërndarjes së mbulueshmërisë ishte si më poshtë:

- Monitoruesi 1 – Lëvizja Vetëvendosje
- Monitoruesi 2 – Partia Demokratike e Kosovës
- Monitoruesi 3 – Lidhja Demokratike e Kosovës
- Monitoruesi 4 – Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
- Monitoruesi 5 – NISMA & AKR
- Monitoruesi 6 – Lista Srpska dhe parti të tjera të komunitetit serb
- Monitoruesi 7 – Të gjitha partitë e tjera të komunitetit joshumicë
- Monitoruesi 8 – Përbajtja nga palë të treta (llogaritë që nuk janë zyrtarisht të lidhura me partitë)
- Monitoruesi 9 – Përbajtja nga palë të treta (llogaritë që nuk janë zyrtarisht të lidhura me partitë)
- Monitoruesi 10 – Përbajtja e mediave dhe OSHC-ve

Përveç monitoruesve, projekti inkurajoi aktivisht palët e interesuara dhe qytetarët që të monitorojnë përbajtjen në mediat sociale dhe të raportojnë çdo vërejtje apo ankesë në organet përkatëse të ankesave zgjedhore. D4D krijoi një email dhe linjë telefonike të veçantë për të mbledhur raportime dhe dëshmi të shkeljeve të kryera. Votuesit dhe akterët e tjerë u ftuan t'i raportojnë përbajtjet e padëshirueshme. Për më tepër, D4D krijoi metoda të përshtatshme për raportim (e-mail, thirrje, WhatsApp, tag) dhe informoi ekzistimin e burimeve të tilla.

Përveç monitorimit manual, mjeti kryesor i përdorur ishte CrowdTangle (CT). CT është një vegël e Facebook e informatave publike që ndihmon botuesit, gazetarët, studiuesit dhe kontrolluesit e fakteve të ndjekin, analizojnë dhe raportojnë se çfarë po ndodhë nëpër mediat sociale në faqet publike të Facebook-ut. Nëpërmjet këtij mjeti 'specifik të Facebook', monitoruesit nxorën "postimet e mbiperformuara" të mediave dhe aktorëve politikë të përzgjedhur nga Kosova lidhur me zgjedhjet gjatë gjithë fushatës. Postimet me performancë të lartë janë postimet që çojnë në ndërveprime më të mëdha nga përdoruesit e Facebook sesa ato mesatar faqe të caktuara. Faqet me numër më të vogël ndjekësish (dhe, rrjedhimisht, një numër më i vogël ndërveprimesh) nuk diskriminohen ndaj atyre faqeve me numër më të madh ndjekësish, sepse vetëm ndërveprimet mesatare në një faqe specifike ofrojnë bazën për analizë. CrowdTangle llogarit performancën e tyre mesatare/standardin bazuar në performancën e 100 postimeve të fundit të secilës

prej mediave dhe aktorëve politikë të ekzaminuar. Monitoruesit kërkuar fjalët kyçe në faqet publike në Facebook dhe Instagram të figurave publike dhe mediave publike. Ata eksploruan dy variabla – faqen e Facebook dhe fjalët kyçe. Të dy variablat janë përzgjedhur nga një studiues serb i Kosovës dhe një studiues shqiptar i Kosovës. Monitoruesit janë trajnuar për përdorimin e CT dhe skemën e monitorimit nga ekspertët të mediave sociale HD për të siguruar cilësi.

Monitorimi u fokusua në shkallën në të cilën partitë politike, kandidatët, mediat dhe OJQ-të respektuan zotimet e dhëna në deklaratë. monitorimin është kryer sipas udhëzimeve në vijim:

- Monitorimi ka mbuluar fushatat zgjedhore në TË GJITHA komunat e Kosovës. Gjithashtu, vëmendje e veçantë iu kushtua përmbajtjes së mediave sociale që prekin komunitetet joshumicë, gratë dhe grupet e tjera të cenueshme.
- Mediat sociale që u monitoruan përfshinin: Facebook, Instagram, Twitter, TikTok, Youtube, Uebfaqe/Blogje, Viber/Whatsapp.
- Monitorimi mbuloi të gjitha reklamat dhe përmbajtjet politike dhe zgjedhore të palëve të treta, mbështetëse dhe aktorëve të tjerë, në formë transmetuese dhe të shkruar, duke përfshirë postimet, deklaratat, komentet, përgjigjet dhe çdo formë tjetër komunikimi.
- Lloji i përmbajtjes së monitoruar përfshinte: gjuhë të urrejtjes, gjuhë degraduese, lajme të rreme, dezinformata, si dhe përmbajtje të tjera shpifëse ose keqdashëse që mund të dëmtonte mjedisin zgjedhor.

D4D krijoi një bazë të dhënash me variabla të koduar paraprakisht për të siguruar mbledhje të njëtrajtshme të të dhënave nga monitoruesit dhe palët e tjera të interesuara. Kjo siguroi që të dhënat e mbledhura nga raportet të përpiloheshin, analizoheshin dhe paraqiteshin në formate gjithëpërfshirëse në raportin përfundimtar. Lloji i të dhënave të mbledhura përfshinte:

- Data e ndodhjes:
- Komuna: menyja rrëshqitëse – lista e komunave
- Shkelësi i supozuar: p.sh. parti politike, palë e tretë/jozyrtare, media, OSHC, mbështetës, ose të tjerë
 - Shkelësi i supozuar: nëse është parti politike, zgjidh nga menyja rrëshqitëse
 - Shkelësi i supozuar: nëse është media, zgjidh nga menyja rrëshqitëse
- Natyra e shkeljes: meny rrëshqitëse - p.sh. dezinformatë, gjuhë e urrejtjes, gjuhë degraduese, shpifje, gjuhë shpifëse.
- Media sociale: meny rrëshqitëse - Facebook, Instagram, Twitter, TikTok, Youtube, Faqe Interneti/Blog, Viber/Whatsapp, etj. Me mundësi të zgjedhjes së opsioneve të shumta.
- Vegëza: Për çdo raportim janë ruajtur vegëzat përkatëse. Përveç kësaj, ekipi i monitorimit duhet të mbledhë pamje nga ekrani, video-regjistrime, audio ose prova të tjera, për t'i mbështetur raportimet. Këto duhet të ruhen në mënyrë të sigurt për secilin raportim.

